

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**

PROGRAMI PËR GJIMNAZET ME MËSIM TË REFORMUAR

PROGRAMI MËSIMOR

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

VITI IV



Shkup, 2003 viti

1. IDENTIFIKIMI I TË DHËNAVE

1.1. Emërtimi i lëndës mësimore: **GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**

1.2. Lloji i arsimimit të mesëm

1.2.1. Drejtimi arsimor: **Për gjimnazet**

1.3. Diferencimi i lëndës mësimore

1.3.1. Lëndë e përgjithshme

1.4. Viti i mësimimit të lëndës mësimore

1.4.1. **Viti i katërt ë**

1.5. Numri i orëve të lëndës mësimore

1.5.1. Numri i orëve javore **4 orë**

1.5.2. Numri i orëve vjetore **124 orë**

1.6. Statusi i lëndës mësimore

1.6.1. **I obligueshëm**

2. QËLLIMI I LËNDËS MËSIMORE

Qëllimi i mësimimit të gjuhës shqipe dhe i letërsisë synon që nxënësi të aftësohet të komunikojë në gjuhën letrare shqipe, t'i përvetësojë karakteristikat thelbësore të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore dhe t'i aftësojë për vetëmësim.

2.1. Qëllimi i përgjithshëm

- të komunikojë në pajtim me normën e gjuhës letrare shqipe në jetën e përditshme, në nivel akademik dhe në nivele tjera;
- t'i zbatojë normat gjuhësore në jetën e përditshme (me gojë dhe me shkrim);
- t'i njohë vlerat letrare dhe të zhvillojë aftësi personale në jetën e përditshme dhe atë profesionale;
- t'i zhvillojë aftësitë individuale për përdorim receptiv e produktiv të gjuhës letrare shqipe në formën e shkruar dhe atë gojore;
- të fitojë dituri socio - linguistike, që do t'i ndihmojë të gjendet në situata të ndryshme;
- të aftësohet për shkollim të mëtutjeshëm nëpër institucionet e arsimit të lartë në aspektin profesional e shkencor;
- të njihet me karakteristikat e letërsisë shqiptare dhe me veçoritë e letërsive të tjera që do ta ndihmojnë njohjen reciproke të kulturave;
- t'i zhvillojë aftësitë e përgjithshme dhe ato të veçanta si: zgjidhjen e problemeve, aftësimin për bashkëpunim, përgjegjësinë përshtatshmërinë dhe kreativitetin;
- Të mund të shfrytëzojë literaturë profesionale (broshura, revista, fjalorë, doracakë) etj;
- Të kenë mundësi edhe mëtej t'i përsosin aftësitë e tyre profesionale në sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional që po bëhet gjithnjë e më interdisciplinar dhe parakusht për kërkimin e informacioneve, mësimin dhe njohjes së gjuhës dhe të letërsisë shqiptare;
- të formojë personalitet me zhvillim permanent të synimeve kognitive (arsimore), psikomotorike (edukative) dhe efektive (funksionale).

2.2. Qëllimi i veçantë i mësimit

- Të përvetësojë materialin nga fusha e gjuhës shqipe dhe letërsisë;
- Të përvetësojë një fond të mjaftueshëm fjalësh që do të ndihmojnë komunikimin në gjuhën amtare letrare dhe do të jenë të kuptueshëm;
- Të aftësohet të gjejë informacione konkrete nga sfera e gjuhës dhe letërsisë me karakter të përgjithshëm ose personal;
- Të aftësohet të bartë informacione të shkruara ose letra që do të jenë të kuptueshme, gjithashtu nxënësit do të aftësohen për thithjen e vlerave të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore.

3. NJOHURITË E NEVOJSHME PARAPRAKE

Pasi nxënësi e ka kryer vitin e tretë, supozohet se gjatë shkollimit të mesëm (vitit të IV) të gjimnazit, i ka përvetësuar njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e mëposhtme:

- kupton globalisht materialin e gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe kanë paranojë optinale mbi të njëjtën dhe atë botërore;
- zotëron një fond të mjaftueshëm fjalësh dhe elementesh gramatikore që u mundëson të shprehen qartë;
- gjen informacione dhe elemente të ndryshme gjuhësore në tekste të caktuara dhe nga burime të ndryshme;
- mund të vjelë informacione në sferën e komunikimit, gjuhës dhe letërsisë.

Megjithatë, duhet të potencohet se arsimtari patjetër duhet të ketë parasysh faktin se nxënësi, edhe përkundër arsimit bazë, do të ketë nevojë për aftësim të mëtutjeshëm, veçmas në gjimnaz ku interesimi është më i madh.

4. PROCESI MËSIMOR

4.1. Struktura e përmbajtjeve mësimore

FUSHA PROGRAMORE: Gjuhë dhe komunikim (62 orë)				
Njësitë mësimore	Numri i orëve	Qëllimet konkrete Nxënësi:	Orientimi didaktik	Korelacioni mes lëndëve dhe fushave programore
STILISTIKA Stilistika letrare		- di ta definojë stilistikën si shkencë; - i kupton bazat e shkencës së stilistikës letrare.	- Ushtrime: Tekste të zgjedhura për ushtrimin e stilit.	Me: Letërsinë, linguistikën.
Gjuha e letërsisë artistike		- ta kuptojë gjuhën si anë,mjet dhe formë të veprës letrare.	- Ushtrime:Nëpërmjet teksteve letrare.	Letërsi, Linguistikë.
Letërsia artistike dhe gjuha letrare kombëtare		- E kupton forcën shprehëse të gjuhës shqipe në letërsi; - E kupton shfrytëzimin e të gjitha mundësive të gjuhës edhe jashta normës letrare; - di ti dallojë elementet jashta normës letrare: ligjerimet historike, krahinore,vetjake,shoqërore,kulturore.	- Ushtrime:Nëpërmjet teksteve letrare të zbulojë forcën shprehëse të gjuhës letrare.	Letërsinë.
Gjuha e prozës		- E kupton ndikimin e letërsisë në lëvrimin e gjuhës shqipe. - di të dallojë rrëfimin në prozë,gjuhën e autorit,personazheve,tipizimin e personazheve. - I kupton tipat e ligjeratës së drejtë dhe	- Ushtrime: tekste të zgjedhura në prozë për të dalluar rrëfimin,gjuhën e shkrimtarit,tipizimin e	Letërsinë.

Gjuha e poezisë		<p>zhdrejtë.</p> <p>- E kupton organizimin e gjuhës në poezi, strukturimin e ritmit dhe anëve të tjera të saj, shumanshmërinë e lidhjeve të fjalëve në poezi.</p>	<p>personazheve.</p> <p>- Ushtrime:Nëpërmjet vjershave poetike mëson organizimin e gjuhës në poezi.</p>	Letërsinë.
Stili i shkrimtarit		<p>- di ti dallojë ndryshimet e veprave sipas epokave dhe drejttimeve letrare,laramaninë e stileve në letërsinë bashkëkohore.</p>	<p>- Ushtrime:Nëpërmjet teksteve poetike.</p>	Letërsinë.
Figurshmëria e gjuhës Kuptimi i figurshmërisë (metafora, metonimia, krahasimi, epiteti, sinegdota, hiperbola, litota, ironia, sarkazmi, perifraza, personifikimi).		<p>- të kuptojë rolin e figurave në gjuhën poetike;</p> <p>- i dallon fjalët e figurshme në tekstet poetike;</p> <p>- di të formulojë tekste poetike me figurat poetike.</p>	<p>- Ushtrime: nëpërmjet teksteve letrare.</p>	Letërsinë.
Figurat e sintaksës dhe llojet e intonacionit (anafora, epifora, enumeracioni, përsëritja, antiteza, gradacioni).		<p>- di të dallojë figurat e sintaksës në tekste letrare;</p> <p>- kupton përdorimin e figurave sintaksore në ligjerimin e folur dhe të shkruar.</p>	<p>- Ushtrime: tekste të zgjedhu-ra letrare për dallimin e mjeteve shprehëse.</p>	Letërsinë.

<p>Fjalori poetik (sinonimet, homonimet, antonimet, arkaizmat, neologjizmat, barbarizmat, provincializmat, huazimet).</p>	<p>- di ti dallojë dhe përdorë drejtë sinonimet antonimet, homonimet etj.</p>	<p>- Ushtrime: tekste të zgjedhura me sinonime, antonime, homonime etj.</p>	<p>Letërsinë, sociologjinë, linguistikën.</p>
<p>Frazeologjizmat Njësitë frazeologjike</p>	<p>- e kupton funksionin e frazeologjizmave në tekste.</p>	<p>- Ushtrime: tekste të zgjedhura me frazeologjizma.</p>	<p>Letërsinë, psikologjinë.</p>
<p>Mjetet shprehëse fonetiko-fonologjike (asonanca, aliteracioni, apostrofa, intonacioni, theksi</p>	<p>- e kupton funksionin e mjeteve shprehëse fonetiko-fonologjike; - di ti dallojë llojet si asonanca, aliteracioni, apostrofa etj.</p>	<p>- Ushtrime në lidhje me mjetet shprehëse fonetiko-fonologjike.</p>	<p>Letërsinë, fonetikën, fonologjinë.</p>
<p>Mjetet shprehëse morfologjike (gjinia, numri, shquarsia e emrave) - shkalëzimi i mbiemrave dhe grupeve të tjera të</p>	<p>- di të zbatojë dituritë e morfologjisë;</p>	<p>Ushtrime: tekste të zgjedhura me stile të ndryshme për këtë qëllim.</p>	<p>Letërsinë, morfologjinë.</p>

<p>fjalëve. - veta e përemrave vetorë dhe foljeve. - koha, mënyra diateza tek folja.</p> <p>Mjetet shprehëse sintaksore, rendi dhe përshtatja gjymtyrëve të fjalisë</p> <p>Paraqitja grafike e tekstit.</p> <p>Mimika dhe gjestikulacioni.</p> <p>Stilistika gjuhësore - gjuha letrare shqipe dhe sistemi i stileve</p> <p>Ligjërimi i folur</p> <p>Ligjërimi i shkruar</p> <p>Stili shkencor</p>		<p>- mund ti dallojë format që kanë të bëjnë me stilin; - mund të bëjë korelacion me mjetet morfologjike dhe stilistike;</p> <p>- di të trajtojë karakteristikat e mjeteve shprehëse morfologjike.</p> <p>- di ti përdorë drejt dituritë nga sintaksa;</p> <p>- e kupton përdorimin e drejtë dhe funksional të gjymtyrëve të fjalisë.</p> <p>- di të dallojë llojet e paraqitjes së teksteve;</p> <p>- di ti dallojë llojet e mjeteve shprehëse të jashtme.</p> <p>- di të zbatojë gjuhën letrare, normën letrare kombëtare; - i dallon sistemet e stileve.</p>	<p>Ushtrime në lidhje me përshtatjen e gjymtyrëve të fjalisë.</p> <p>Ushtrime:shfrytëzohen video-materiale.</p> <p>- Ushtrime:nëpërmjet teksteve të dallojë gjuhën letrare dhe sistemet e stileve.</p>	<p>Letërsinë, sintaksën.</p> <p>Letërsinë.</p> <p>Letërsinë.</p>
---	--	---	--	--

Stili shtetëror-administrativ	- i kupton llojet e ligjërit të folur dhe rolin e tij stilistik.	- Ushtrime:mjete audio-vizuele.	Letërsinë, fonetikën, morfologjinë.
Stili politiko-shoqëror	- e dallon ligjerimin e shkruar,tiparet kryesore fonetike,gramatikore e leksikore.	- Ushtrime:tekste të zgjedhura.	Letërsinë
Gjatë vitit shkollor do të bëhen tre hartime (nëntë orë)	- e kupton stilin shkencor dhe funksionin e tij.	- Ushtrime:tekste konkrete për ta kuptuar stilin dhe funksionin e tij.	Letërsinë
Dialektologjia	- e dallon stilin shtetëror-administrativ dhe i zgjeron dituritë nga stilistika.	- Ushtrime:tekste për ushtrimin e stilit shtetëror-administrativ.	Letësinë
Dialektet e gjuhës shqipe	- mund ti kuptojë sferat dhe funksionin e gjuhës politiko-shoqërore.	- Ushtrime:tekste të zgjedhura mbi stilin politiko-shoqëror,duke shfrytëzuar mjetet informative.	Letërsinë,mjetet informative.
Gegërishtja dhe nëndialektet e saj	- di të bëjë hartime me stilin dhe gjuhën që është më i përshtatshëm për një hartim të sukseshëm.		
Toskërishtja dhe nëndialektet e saj	- di të bëjë radhitjen logjike të gjërave, korelacionin e duhur dhe etapat e hartimit (hyrja,pjesa kryesore,përfundimi).		
Dallimet ndërmjet dialekteve në fushë të fonetikës e	- di të përdorë shprehje dhe fraza sa më të kuptuashme që përcakton hartimin.		
	- ta kuptojë dialektologjinë si shkencë.	Ushtrime:tekste për dialektet e gjuhës shqipe.	Letërsinë,fonetikën, morfologjinë,leksikologjinë.
	- i kupton dialektet e gjuhës shqipe dhe karakteristikat themelore.		
	- e dallon gegërishten dhe nëndialektet e		

<p>fonologjisë</p> <p>Dallimet ndërmjet dialekteve në fushë të morfologjisë</p> <p>Dallimet ndërmjet dialekteve në fushë të leksikut</p> <p>Onomastikë Lënda e studimit të onomastikës</p> <p>Studimet onomastike shqiptare</p> <p>Toponimia dhe degët e saj (oronimia, hidronimia, ojkonimia)</p> <p>Antroponimia dhe degët e saj (emrat personale të njerëzve, mbiem</p>		<p>saj.</p> <p>- e dallon toskërishten dhe nëndialektet e saj.</p> <p>- i dallon ndryshimet ndërmjet dialekteve në fushë të fonetikës e fonologjisë.</p> <p>- i dallon ndryshimet ndërmjet dialekteve në fushë të morfologjisë.</p> <p>- i kupton ndryshimet ndërmjet dialekteve në fushë të leksikut.</p> <p>- e kupton onomastikën si shkencë.</p>		<p>Linguistikën, stilistikën, letërsinë, leksikologjinë,</p>
--	--	--	--	--

<p>rat, nofkat).</p>		<p>- i kupton studimet onomastike shqiptare.</p> <p>- njeh dhe dallon toponominë dhe degët e saj, dallon oronimet, hidronimet dhe ojkonimet.</p> <p>- njeh dhe dallon antroponominë dhe degët e saj.</p>	<p>- Ushtrime: trajtimi i materialit onomastik.</p> <p>- Ushtrime: trajtimi i materialit onomastik shqiptar</p> <p>- Ushtrime:shqyrtimi i toponomive në tekste adekuate.</p> <p>- Ushtrime:emrat dhe mbiemrat e njerëzve, si edhe nofkat.</p>	<p>leksikografinë.</p> <p>Gjeografinë, dialektologjinë, historinë e gjuhës.</p> <p>Me historinë, religjionin sociologjinë.</p>
----------------------	--	--	---	--

FUSHA PROGRAMORE: LETERSI DHE LEKTYRË (62 orë)				
Njësitë mësimore	Numri i orëve	Qëllimet konkrete Nxënësi:	Orientimi didaktik	Korelacioni mes lëndëve dhe fushave programore
Letërsia e pas Luftës së Dytë Botërore		<ul style="list-style-type: none"> - i kupton proceset letrare dhe tendencat e reja zhvillimore.... - i dallon veçoritë e letërsisë së diasporës, tematikat e letërsisë së re, mënyrën e integritit të letërsisë sonë me përvojën e artit letrar botëror... 	<p>Arsimtari grumbullon materiale, jep sqarime, komenton, hulumton, analizon, krahason...</p>	Me historinë dhe gjeografinë, religjionin.
Poezia bashkëkohore		<ul style="list-style-type: none"> - i dallon trajtat e poezisë filozofike.. - kupton lidhjen e poezisë së re shqipe me atë moderne evropiane e botërore... - i dallon prirjet intime të poezisë së re, elementet e reja dhe risitë karshi vargut tradicional... 	<p>Grumbullon materiale vizuele-fotografi, tekste autorësh të periudhës letrare në fjalë, shkrime gazetash e revistash të njohura...</p>	- Me artin muzikor, atë figurativ dhe me filmin
Proza bashkëkohore		<ul style="list-style-type: none"> - i kupton rrugët zhvillimore të prozës shqipe dhe zhvillimin e formave të tregimit dhe romanit të kësaj periudhe... - dallon prirjet e prozës realiste...dhe karakteristikat e prozës së realizmit socialist... - dallon tipet e ndryshme të romanit (shoqëror,psikologjik,historik...) - kupton prirjet moderne në prozën shqipe dhe zbërthen gjuhën e figurshme të kësaj letërsie... 	<p>Prezanton tekste origjinale të autorëve të kësaj periudhe letrare, prezanton me manjetofon materiale të inçizuara në kaseta...</p>	

Drama bashkëkohore	<ul style="list-style-type: none"> - mund të kuptojë dramën me ndërtim klasik dhe temë folklorike dhe kombëtare - dallon simbolikën dhe orientimet e dramës moderne shqipe, mbështetjen në mitologjinë shqiptare... - kupton lidhjet e tekstit të dramës me shfaqjen teatrore, tipologjinë e dramave shqipe... 	Prezanton veprat dramatike të autorëve kryesorë të kësaj periudhe, prezanton shfaqjet dramatike të xhiruara nëpër shirita videokasetash...	Me filmin
Kritika dhe historia e letërsisë shqipe	<ul style="list-style-type: none"> - dallon rrugën zhvillimore të kritikës dhe llojet e studimeve letrare... - kupton metodat e reja kërkimore të studimeve letrare... 	Lexon pjesë të zgjedhura të shkrimeve kritike...	
Petro Marko	<ul style="list-style-type: none"> - jeta dhe aktiviteti letrar dhe publicistik i shkrimtarit... - di ta zbërthejë (analizojë) romanin “Hasta la vista”... - Dallon karakteristikat e veprës romaneske të Petro Markos... - komenton lirikat dhe shkrimet publicistike të autorit... 	Komenton pjesë të rëndësishme të veprës letrare “ Hasta la vista “ ...	Me historinë, gjeografi në dhe arte tjera...
Jakov Xoxa	<ul style="list-style-type: none"> - jeta dhe aktiviteti letrar i autorit... - kupton elementet realiste të romanit të J. Xoxës, funksionin e detajeve, të përshkrimet dhe mendimet e prozës së tij... 	Analizon gjuhën e veprës dhe stilin e peizazheve të papërsëritshme të romanit “ Lumi i vdekur “...	

<p>Martin Camaj</p>	<p>- analizon romanin "Lumi i vdekur", zbërthen formën e tij sociale, lidhjet Kosovë -Shqipëri' kuptimin simbolik të romanit, ndërtimin e romanit mbi bazën e konflikteve të thella shoqërore, kompozicionin dhe shprehjet e pasura gjuhësore...</p> <p>- jeta dhe aktiviteti letrar i autorit... - kupton lidhjet e veprës së M.Camajt me traditën tonë dhe atë botërore... - dallon gjuhën metaforike dhe tiparet e poezisë së tij lirike dhe meditative... - analizon vëllimin poetik "Njeriu më vete dhe tjerë" ...</p>	<p>Zbërthen simbolikën e fuqishme dhe origjinale të veprës "Dranja", gjuhën e veçantë të veprës së tij...</p>	<p>Me historinë e gjuhës shqipe dhe me artet tjera...</p>
<p>Kasëm Trebeshina</p>	<p>- jeta dhe vepra e autorit..... - kupton përpunimin filozofik të subjekteve... - dallon elementet e dramës së absurdit në veprën e autorit...elementet e prozës sonë popullore... - di të zbërthejë prozën "Odin Mondvalsen"...</p>	<p>Analizon alegorinë e novelës "Odin Mondvalsen", personazhin kryesor dhe karakteristik të saj ...</p>	<p>Me historinë e re shqiptare dhe me dramën e filmin...</p>
<p>Dritoro Agolli</p>	<p>- jeta dhe vepra letrare në vargje e prozë... - kupton mënyrën e pasqyrimit të jetës në poezinë e Agollit...</p>	<p>Analizon romanin "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo", komenton ndikimin e krijimtarisë gojore në veprën e tij ...</p>	<p>Me historinë, gjeografinë e artin muzikor e figurativ...</p>

Ismail Kadare	<ul style="list-style-type: none"> - dallon strukturën tradicionale në veprën e tij poetike, risitë figurative të lirikave intime... - bio-bibliografia e autorit... - njeh motivet e poezisë dhe prozës së tij... - dallon tiparet moderne të prozës së tij- simbolet, nëntekstet, groteskun dhe alegorinë e veprës së tij madhore... - analizon romanet “Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ dhe “Kronikë në gur”... - komenton poezitë dhe prozat e I. Kadaresë 	<p>Analizon kryeveprat e autorit dhe mënyrën moderne të strukturimit të romanit kadarean...</p> <p>Komenton prezencën e mitit në romanin e tij dhe gjuhën e papërsëritshme...</p>	<p>Me historinë shqiptare dhe botërore, me gjeografinë, mitologjinë greko-romako-ilire, me religjionet dhe artet tjera...</p>
Anton Pashku	<ul style="list-style-type: none"> - jeta dhe formimi letrar i autorit... - dallon të veçantën e veprës së tij letrare në prozë e dramë... - kupton gjuhën e figurshme dhe simbolikën e veçantë të veprës së tij... - mund të analizojë romanin “Oh”, shtresimet rrëfimtare të romanit (historinë ilire, aktualitetin shqiptar, stilin e veçantë) 	<p>Zbërthen strukturën interesante të romanit dhe tregimeve të tij poetike...</p> <p>Analizon gjuhën e ngjeshur e koncize të veprës së autorit.</p>	<p>Me historinë dhe artet tjera...</p>
Azem Shkreli	<ul style="list-style-type: none"> - bio-bibliografia e autorit... - kupton veçoritë e veprës së tij në vargje, prozë e dramë... - dallon format tradicionale të vargut dhe mendimit të tij filozofik... 	<p>Analizon poezitë antologjike dhe tregimet e përmbledhjes “Sytë e Evës“...</p>	<p>Me artet tjera...</p>

Adem Gajtani		<p>-Aëllimin “ Nga Bibla e heshtjes “ dhe “Sytë e Evës“...</p> <p>- jeta dhe vepra letrare... - kupton rëndësinë dhe mesazhet e poezisë së autorit... - analizon përmbledhjen “As dru as zog, dashuri“</p>	Analizon poezitë më të mira të autorit...	Me historinë...
Ali Podrimja		<p>- bio-bibliografia e autorit... - di evolucionin e krijimtarisë së tij poetike dhe elementet filozofike-meditative... - analizon vëllimin poetik “Lum Lumi“.. - komenton ndërtimin e vargjeve dhe gjuhën e tyre të figurshme...</p>	Analizon poezitë më të arrira të përmbledhjes “Lum Lumi” dhe prezenton recitimet e disave prej tyre...	Me artet tjera...
Letërsia moderne botërore		<p>- njeh rrugën e zhvillimit të letërsisë dhe momentet politike e shoqërore që ndikuan në këtë zhvillim, përfaqësuesit kryesorë të rrymave të ndryshme letrare... - dallon drejtimet letrare dhe karakteristikat e letërsive të vendeve të ndryshme të botës...</p>	Grumbullon materiale me peshë për këtë periudhë letrare- shkrime revistash e gazetash të kohës dhe prezenton veprat e disa letrarëve kyç...	Me historinë, gjeografinë dhe religjionin...
Xhejms Xhojs		<p>- jeta dhe krijimtaria letrare e autorit... - kupton krijimtarinë letrare të Xhejms Xhojsit...</p>	Komenton romanin “Uliksi” karakteristikat e tij, temën, personazhet, formën dhe gjuhën e veprës...	Me artet tjera...

Franc Kafka	<ul style="list-style-type: none"> - jeta dhe vepra letrare e F.Kafkës... - kupton filozofinë shoqërore të autorit... 	Komenton veprat "Procesi" dhe "Letër babait" dhe veçantitë e prozës së këtij autori tejet origjinal...	Me filozofinë, psikologjinë, filmin dhe artet tjera...
Lorka	<ul style="list-style-type: none"> - jeta dhe vepra letrare... - e kupton poezinë dhe esetë e autorit... - dallon elementet psikologjike dhe estetike të veprës së autorit... 	Analizon kompozicionin dhe gjuhën e veprës së autorit...	
Alber Kami	<ul style="list-style-type: none"> - jeta dhe vepra letrare e autorit... - e kupton filozofinë ekzistencialiste të A. Kamysë... - analizon veprën "I huaji" (temën, idenë, personazhet...) 	Analizon veprimin e personazhit kryesor të romanit "I huaji" dhe simbolikën e veprës në fjalë..	Me psikologjinë, filozofinë dhe artet...
Ernest Heminguej	<ul style="list-style-type: none"> - bio-bibliografia e autorit... - kupton veçoritë e metodës krijuese të Heminguejit... 	Analizon romanin "Plaku dhe deti"...	Me filmin dhe artet tjera...
Borhesi	<ul style="list-style-type: none"> - jeta dhe vepra e autorit... - kupton metodën krijuese të autorit... 	Analizon tregimet më të mira nga përmbledhja e tij "Tregime"....	Me artet tjera dhe dramën...
Gabriel Garsia Markes	<ul style="list-style-type: none"> - jeta dhe vepra e autorit... - njeh metodën krijuese të autorit... - analizon veprën "Njëqind vjet vetmi" (personazhet, kompozicionin, stilin...) 	Analizon alegorinë e novelës "Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë" dhe elementet autobiografike të romanit "Njëqind vjet vetmi"...	Me historinë dhe artet tjera...

		LISTA ELEKTYRAVE (10 orë)		
1. Ismail Kadare		“Lindja, jeta dhe vdekja e Lul Mazrekut”	Nxënësi të njihet me veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe dhe asaj botërore që janë në listën e propozuar. Të aftësohet t’i vlerësojë vlerat pozitive të veprave letrare në aspekt të përmbajtjes dhe të formës. Posaqërisht t’i analizojë vlerat e autorit në raport me kohën, vendin dhe temën që trajton. Gjatë vitit të analizohen 6 vepra nga lista e propozuar sipas zgjedhjes së arsimtarit dhe nxënësit.	
2. Teki Dërvishi		“Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit”		
3. Nehas Sopaj		“Unaza e humbur”		
4. Ridvan Dibra		“Nudo”		
5. Beqir Musliu		“Vegullia”		
6. Xhevahir Spahiu		“Ferrparajsa”		
7. Xhabir Ahmeti		“Tregime”		
8. Ernest Sabato		“Tuneli”		
9. Danillo Kish		“Varreza për Boris Davidoviçin”		
10. Paulo Kuejlo		“Alkimisti”		
11. Xhevdet Bajra		“Kur engjëjt qajnë”		
12. Murat Isaku		“Rreckajt”		

4.2. Metodatat mësimore dhe aktivitetet për mësim

Metodologjia e propozuar e mësimin bazohet në supozim se gjuha shqipe përdoret si lëndë mësimore deri në shkallën më të lartë të arsimit. Arsimtari patjetër të zbatojë metoda funksionale të mësimin, me theks të veçantë në aktivitetet e nxënësit, të cilët bazohen në interesimin e tyre me qëllim që të krijohen kushte të volitshme për mësim. nga metodatat mësimore propozojmë të përdorë parasegjithash atë të bisedës, shpjegimit, demonstrimit, punës në grupe, punës me tekst, në çifte etj...

Të respektojë karakterin shkencor të të mësuarit, sistematizimin dhe gradualitetin si dhe të përpiqet të vë në zbatim lidhjen e teorisë me praktikën. Sa i takon gjuhës është e rëndësishme që në mënyrë permanente të shkohet nga niveli funksional dhe ai sistematik, me qëllim që të ruhet motivimi i nxënësve për zbatimin e gjuhës letrare shqipe.

T'u mundësohet nxënësve sa më shumë që është e mundur ta shfrytëzojnë gjuhën letrare shqipe në kontekst funksional, si të arritura gjuhësore si dhe ato letrare me qëllim që të mundësohet zbatimi i tyre.

Nga format e punës është e udhës që pas asaj frontale të përdoret edhe ajo në grupe, në çifte dhe individuale. Poashtu gjatë realizimit të materialit mësimor arsimtari duhet të përdor sa më shumë mjete mësimore vizuale (libra, fletëza mësimore, pyetësor, revista për të rinj), teknikë (kompjuter, televizor, video, manjefon etj), me anë të të cilëve do të vijnë në shprehje aktivitetet e nxënësve.

Tema të tëra duhet të realizohen me anë të sistemit problemor, kërkimor aktiv të të mësuarit. Aktivitetet e nxënësit do të vijnë në shprehje përmes : vrojtimit, dëgjimit, shënimit, ushtrimeve, leximit, zgjidhje të problemeve, qoftë në grupe ose individuale, duke ardhur në shprehje puna e pavarur e nxënësit.

Aktiviteti i nxënësit : interesohet, parashtron pyetje, shpreh mendimin e tij, propozon zgjidhje, vështron, zbulon (ndryshime), evidenton të dhëna, kontrollon, përputh mendimet me anëtarët e grupit...

Aktiviteti i arsimtarit: planifikon, bën përgatitje (hapsinore, mjetet mësimore dhe didaktiko metodike), parashtron problemin, jep kahje, ndihmon, koordinon dhe vështron punën e grupeve dhe individëve, jep informata, demonstroi, përcjell, vlerëson (punën e vet dhe të grupit), ven kontakt pozitiv pedagogjik duke komunikuar me nxënësin dhe arsimtarët tjerë.

4.3. Organizimi dhe realizimi i mësimin në lëndën Gjuhë shqipe dhe letërsi

Sipas qëllimit të parashtruar, lënda mësimore realizohet në mësojtore të specializuar për mësim teorik, në dy gjysëmvitet, me orë javore të obligueshme. Puna e pavarur e nxënësit mund të realizohet në shkollë dhe në shtëpi si detyrë shtëpie.

4.4. Mjetet mësimore dhe ato ndihmëse

Për t' u realizuar qëllimi i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi në gjimnaze propozojmë mjetet mësimore:

1. Pajisjet e rëndomta: bankat, karriget, dërrasa (tabelën).
2. Grafoskopin (mund të jetë i pë përbashkët për më shumë lëndë mësimore).
3. Vend për ruajtje të sigurt të completeve të paraleles dhe të librave me referenca (dolape, rafte).
4. Përdorimi i internetit në hapsirat ku janë të instaluar kompjuterët.
5. Kasetofoni dhe videorekorderi...(TV mund të jetë i përbashkët).

Gjatë realizimi të programit të lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi, nxënësve dhe arsimtarëve u sugjerohen materialet:

1. Libri i leximit (viti i katërtë).
2. Libri i gramatikës (viti i katërtë).
3. Teksti i teorisë së letërsisë.
4. Doracaku për nxënës.
5. Doracaku për mësues.
6. Parapagimi i revistave të vlefshme profesionale (përmes shkollës).
7. Përdorimi i fotokopjes dhe aparateve tjera për shtypje.

5. NOTIMI DHE REZULTATI I NXËNËSIT

Dituritë dhe aftësitë e nxënësit do të notohen në mënyrë permanente gjatë tërë vitit dhe në drejtim të motivimit të tij. Notimi duhet t' i përfshijë parasegjithash të gjitha qëndrimet pozitive, dituritë, aftësitë dhe sjelljet e nxënësit me qëllim që të stimulohet për përparim dhe vetëiniciativë të tij. Nxënësi duhet të vlerësohet me 8 nota gjatë vitit shkollor. Ky numër parashihet për dy gjysëm vite. Gjatë gjysëm vitit të parë, 2 nota, të bazuara në dituri, aftësi dhe detyra të kontrollit, 2 nota në fushën e komunikimit dhe 3 nota do të jenë të hartimeve. Aspekti gramatikor dhe ai i drejtshkrimit të gjuhës vlerësohet përmes ushtrimeve dhe detyrave të kontrollit. Pasojat e nxënësve në rast të mosuksesit do të jenë në përputhshmëri me ligjin për shkollat e mesme.

6. PARAKUSHTET MATERIALE DHE KADROVIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

6.1. Karakteristikat themelore të arsimtarit

Arsimtari i lëndës **Gjuhë shqipe dhe letërsi** duhet të posedojë karakteristika personale, profesionale dhe pedagogjike të cilat janë:

- të jetë i shëndoshë fizikisht dhe psikikisht;
- të njohë gjuhën letrare shqipe dhe shkrimin e saj;
- të mos ketë pengesa në të shprehurit gojor;
- të jetë komunikativ dhe i hapur për bashkëpunim;
- të ketë përgatitje përkatëse profesionale, me ose pa përvojë pune;
- ta dojë punën pedagogjike dhe të përparojë në këtë profesion;
- të jetë organizator i mirë, kreativ dhe i aftë për të zbatuar risi në metodologjinë mësimore etj.

6.2. Standardi i kuadrit mësimdhënës

Lëndën **Gjuhë dhe letërsi shqipe** në shkollën e mesme të gjimnazit mund ta mbajnë mësimdhënësit që kanë kryer:

1. Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor).
2. Fakultetin Filozofik, Grupin e Letërsisë Shqipe dhe Gjuhës (drejtimi arsimor).

6.3. Standardi hapsinor

Lënda **Gjuhë dhe Letërsi Shqipe** për ta arritur qëllimin e parashikuar duhet të realizohet në mësojtore të specializuara, ose kabinet i dedikuar për këtë lëndë mësimore.

7. DATA E PËRGATITJES DHE BARTËSI I PROGRAMIT

7.1. Data e hartimit: Dhjetor 2003

7.2. Përbërja e grupit punues :

1. Selver Ramadani - këshilltar në Byronë për Zhvillimin e Arsimit - Kumanovë - bartës;
2. Fatmir Sulejmani - këshilltar në Byronë për Zhvillimin e Arsimit - Tetovë;
3. Dr. Xhemaludin Idrizi - profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe - drejtor në gjimnazin “Zef Lush Marku“ - Shkup;
4. Dr. Zeqir Kadriu - zëvendës drejtor në Byronë për Zhvillimin e Arsimit - Shkup;
5. Dr. Nehas Sopaj - profesor në F. Filologjik - Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe - Shkup;
6. Dr. Remzi Nesimi - profesor në F. Filologjik - Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe - Shkup

8. FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Data e fillimit: 01.09.2004

9. MIRATIMI I PROGRAMIT MËSIMOR

Programi i lëndës Gjuhë Shqipe dhe Letërsi u lejua të përdoret-----

----- me vendimin numër ----- të datës ----- viti 2004